



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, me 11 nëntor 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

**nga mbledhja e Komisionit për Mandate, Imunitete
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Džezair Murati, Suzan Novoberdaliu, Ramadan Gashi, Hydajet Hyseni, Fatmire Berisha, Besa Gaxherri, Radmilla Vujoviç dhe Ismet Beqiri.

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Ahmet Isufi, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 27.10.2008**
- 3. Miratimi i Rregullores së Kuvendit të Kosovës**
- 4. Shqyrtimi i propozimit për marrjen e statusit të deputetit të Kuvendit,
z.Sabit Rrahmani**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.10.2008

Procesverbali nga mbledhja e datës 27.10.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Rregullores së Kuvendit të Kosovës

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes tha, unë kisha deshtë ti falënderoi organizatat ndërkombëtare si: NDI, OSBE-në, ICO-në, e sidomos administratën që ka qenë mjaft i përkushtuar gjatë hartimit të rregullores. Ne e konsiderojmë se kjo është një rregullore e kompletuar, e cila do ti procedohet Parlamentit të Kosovës. Ne kemi kërkuar që të bëhet leximi dy herë në mënyrë që ti marrim të gjitha vërejtjet e deputetëve parasysht, dhe që të bëhet një rregullore sa më funksionale.

Ismet Beqiri tha, unë kisha kërkuar që përfundimisht të bëhet edhe një korrigjim në aspektin gjuhësor, pra të lekturohet.

Besa Gaxherri tha, edhe unë i falënderoi të gjithë për bashkëpunim, sepse është bërë një punë e gjatë, prandaj mendoj se ky version mund të shkoj në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim. Megjithatë, unë ngulë këmbë që tek rregulla 24, që ka të bëjë me shkarkimin nga funksioni i Presidentit të Kosovës, mendoj aty nuk duhet të figuroj fjala shkelje ë rënd e Kushtetutës, sepse është Gjykata Kushtetuese ajo e cila do ta vlerësoj se çfarë shkelje është bërë. Gjithashtu tek komisionet kamë kërkuar dhe do ta kërkoj edhe në seancë, që komisionin për buxhet ta udhëheq opozita.

Džezair Murati tha, edhe unë i falënderoi të gjithë për bashkëpunim dhe pajtohem me z.Beqiri, që ky draft duhet edhe njëherë para se të procedohet në seancë plenare të lekturohet.

Hydajet Hyseni, parashtrori disa vërejtje që kishin të bënin me rregullën 5), ai gjithashtu tha se çështjen të cilën e parashtrori znj.Besa Gaxherri, në parim nuk e kundërshtoi nevojën për të pas një komision që bënë kontrollin financiar, por meqenëse grupet parlamentare në fillim të legjislaturës merren vesh për strukturën e komisioneve dhe drejtimin e tyre, pune kjo që është bërë tashme, prandaj mendoj që ne mund ta parashohim këtë si një zgjidhje për legjislaturën e ardhshme.

Komisioni konkludoi se me vërejtjet që u parashtruan Rregullorja e Punës u miratua në komision dhe mund të procedohet për seancë plenare.

3. Shqyrtimi i propozimit për marrjen e statusit të deputetit të Kuvendit, z.Sabit Rrahmani

Kryesuesi njoftoi se: në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, ne e kemi bërë formën procedurale dhe po ashtu në bazë të kësaj rregulloreje Kryetari i Kuvendit, ka kërkuar nga komisioni, që ti bëhet rekomandim Kryesisë së Kuvendit, të cilën ne duhet ta miratojmë tani. Ky rekomandim do ti paraqitet Kryesisë së Kuvendit, e cila pastaj do të paraqitet para deputetëve.

Anëtarët e komisionit e miratuan rekomandimin e propozuar.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati çështje për diskutim.

Ahmet Isufi
Kryetar i Komisionit për
Mandate, Imunitete dhe Rregullore të
Punës së Kuvendit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit